



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.33, datë 10.07.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME VAU-DEJËS SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence*" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "*Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 10.07.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Vau i Dejës sh.a.",

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Vau - Dejës (**UK Vau - Dejës**) me shkresën nr. 18 prot. datë 05.02.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik të UK Vau - Dejës në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqëruës, rezulton:
 - a) Shoqëria UK Vau - Dejës ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 11 057 banorë në Bashkinë Vau - Dejës;
 - b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Mark Ndoci zotëron diplomë Bachelor në Inxhinieri Mekanike marrë në maj të vitit 2018 dhe ka 1 vit përvojë në profesion.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vau - Dejës, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.
5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Vau - Dejës, rekomandon:
- Shoqëria UK Vau i Dejës duhet të punojë në drejtim të zgjerimit të zonës së shërbimit në mënyrë që të gjithë banorët e Bashkisë Vau i Dejës të marrin shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura nga kjo shoqëri me cilësi dhe brenda standardeve.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Vau - Dejës është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime UK Vau - Dejës sh.a me NUIS L67302001M në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime UK Vau - Dejës sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues Ligjor - znj. Klomentina Drini
 - b) Drejtues Teknik - z. Mark Ndoci
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime UK Vau - Dejës sh.a është:

Bashkia Vau – Dejës
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime UK Vau - Dejës sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime UK Vau - Dejës sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI